

OMISSIS

{vulë}

**Verbal i Këshillit të Administrimit  
i datës 13.11.2009**

Janë të pranishëm të gjithë këshilltarët e Administrimit.

Janë gjithashtu të pranishëm, për Kolegjin e Ekspertëve Kontabël, doktor Luca Bicocchi dhe doktor Marco Bosatra; mungon me justifikim doktor Giuseppe Alessio Verni.

**Rendi i ditës**

1. Leximi dhe miratimi i verbalit të mëparshëm
2. Aprovimi i rritjes së kapitalit të Saulus Tirana dhe marrje e vendimit mbi huanë për ortakët dhe aprovimi i marrëveshjes së pjesëmarrjes financiare me Finest S.p.A.
3. Njoftim i Presidentit

**1. Leximi dhe miratim i verbalit të mëparshëm**

U lexua verbali i mbledhjes së Këshillit të Administrimit të datës 30.09.2009, i cili u miratua unanimisht.

**3. Njoftimi i Presidentit**

Presidenti njoftoi se i ka përcaktuar kontratat lidhur me blerjen e Studio Biomedico dhe se në fillim të bashkëpunimit me doktorët Lombardo dhe Bernard, sipas orientimeve të cilat janë dhënë në mbledhjen e Këshillit të Administrimit të datës 30.09.2009 dhe të datës 11.06.2009.

Presidenti informon gjithashtu se më se fundmi është përmbyllur blerja e magazinës e cila ndodhet në Largo Papa Giovanni me një shumë prej Euro 170.000,00.

## **2. Aprovimi i rritjes së kapitalit të Salus Tirana dhe marrja e vendimit për dhënien e huasë ortakëve**

Presidenti e përmbledh situatën duke iu referuar më specifikisht negociimit me Finest me objekt pjesëmarrjen e kësaj të fundit në kapitalin e shoqërisë Salus Tirana.

Zëvendës Presidenti, doktor Stock, sqaron se rritja e Kapitalit të Shoqërisë do të jetë e shumës 4.800.000 Euro dhe si pasojë do ta çojë kapitalin e shoqërisë Salus Tirana në 4.900.000 Euro.

Gjysma e rritjes së Kapitalit të Shoqërisë, për një shumë prej Euro 2.400.000, është në ngarkim të Policlinico Triestino, i cili do të procedojë me financimin në mënyrën që vijon:

- 1.400.000 Euro nëpërmjet ngritjes së një financimi bankar i cili do të përfitojë prej lehtësirave të parashikuara nga Ligji 100 përmes uljes së taksave të interesit (që sot kanë një vlerë prej 2,30%);
- 500.000 Euro përmes aderimit të Finest;
- 500.000 Euro përmes aderimi të Fondit Ballkanik apo, në rastin kur kjo nuk do të jetë e mundur, nëpërmjet aderimit të Finest.

Përgjigja e kërkesës së bërë për aderimin e Fondo Balkani do të bëhet e njohur pas disa muajsh, në përfundim të procedurës hetimore pranë Komisionit Ministror të ngarkuar, e megjithatë kuota e rritjes së Kapitalit të Shoqërisë do të nënshkruhet veçse në një moment të dytë.

Gjysma e mbetur e rritjes së Kapitalit të Shoqërisë, e barabartë me 2.400.000 Euro, do të nënshkruhet prej ortakut shqiptar doktor Olti Pecini, në dy faza: e para kontekstualisht me Policlinico Triestino dhe Finest për një shumë të barabartë me 1.900.000 Euro dhe pjesa e mbetur, e barabartë me 500.000 Euro në momentin e aderimit të Fondit Ballkanik ose, në rast përmbylljeje negative të hetimit, të Finest.

Sigurisht shoqëria ka analizuar, me asistencën ligjore përkatëse, standardet kontraktuale të propozuara prej Finest, duke negociuar disa aspekte me qëllim sqarimin e raportit. Marrëveshja parashikon detyrimin e Policlinico Triestino S.p.A. që të marrin përsipër kuotën e Finest, sipas atyre për çka është rënë dakord në vetë marrëveshje.

Presidenti njofton lidhur me situatën e avancimit të punimeve të ndërtesës, të cilat sot janë të një shume prej Euro 1.200.000,00, të certifikuara nga ark. Semarani. Bëhet i

nevojshëm një financime tjeteër prej Euro 200.000,00 të cilat – sikurse ato më përpara – do t'i kalojnë kapitalit të shoqërisë si rritje në kapitalin e shoqërisë në të cilën ata kanë pjesëmarrje.

Ndërhyjnë në diskutim doktor Stock dhe doktor Polacco; i pari sqaron, unanimitisht me Presidentin, se ndërtimi i klinikës do të përfundojë në vjeshtë të vitit 2011. Duke nisur që nga pranvera e vitit 2010, shoqëria ka në program të vendosë kontakt midis mjekëve të Policlinico Triestino S.p.A. dhe realitetit shqiptar, me qëllim parapërgatitjen e kushteve të punës së Salus Tirana.

Dok. Danelon njofton gjithashtu se ka kontaktuar me investitorë të mundshëm të cilët janë rezidentë në rajon, me të cilët do të organizohen takime në javët e mëpasshme.

Këshilli merr vendim unanimitisht mbi dhënien e financimit për Salus Tirana të një shume prej 200.000,00 (dyqind mijë, sipas skemës kontraktuale që analizohet dhe aprovohet, pra me afat përfundimtar për kthimin datën 31.12.2009. Gjithashtu, Këshilli, gjithmonë unanimitisht, merr vendimin të nënshkruajë për shumën maksimale prej Euro 1.400.000,00 (një milion e katërqind mijë) Kapitalin e Shoqërisë Salus Tirana, në kuadër të rritjes së kapitalit të shoqërisë me Euro 4.800.000,00 (katërmilionetëqindmijë), e nënshkruar përgjysmë prej ortakut shqiptar Olti Pecini dhe për mbetjen prej 1.000.000,00 është nënshkruar prej Finest dhe, nëse është e mundur, prej Fondit për Ballkanin.

Këshilli gjithashtu nxjerr në pah një rifreskim të marrëveshjes së mëparshme me ortakun shqiptar për opearcionin e kapitalit siç është përshkruar më sipër, që parashikon formalizimin e kontratës së blerjes së tokës prej shoqërisë shqiptare, kontestualisht me rritjen e kapitalit.

Për sa i përket derdhjes së shumës prej Euro 1.400.000,00, Këshilli merr vendimin gjithashtu që të zbatohen kushtet më të mira të mundshme të tregut, si me mjete të vetat ashtu edhe me sigurim nga jashtë.

Takimi pezullohet përkohësisht në orën 17.20.

Presidenti  
(firma)

Sekretari  
(firma)

**Vazhdimi i verbalit të Këshillit të Administrimit të datës 13 nëntor 2009.**

Janë të pranishëm të gjithë këshilltarët e Administrimit.

Janë gjithashtu të pranishëm, për Kolegjin e Ekspertëve Kontabël, dok. Luca Bicocchi dhe dok. Marco Bosatra; mungon me justifikim dok. Giuseppe Alessio Verni.

Takimi rinis në orën 17.25.

**2- bis. Aprovimi i marrëveshjes së pjesëmarrjes financiare me Finest s.p.a.**

Mbi të gjitha, vë në dukje Presidenti, kontrata me Shoqërinë Financiare të Promovimit të Kooperimit Ekonomik me vendet e Europës Lindore – Finest S.p.A. e Pordenone lidhur me investimin për realizimin e Klinikës në Tiranë.


Financiarja Finest S.p.A. ka si qëllim në fakt të marrë pjesë në rritjen e kapitalit të parashikuar të shoqërisë së të drejtës shqiptare të quajtur “Salus Tirana shpk”, me seli në Tiranë, me nëshkrimin dhe derdhjen e Euro 500.000 (pesëqindmijë) nëpërmjet dorëheqjes prej të drejtës së opsionit mbi kuotat prej ortakëve aktualë sipas ligjit në fuqi.

Kapitali i shoqërisë “Salus Tirana shpk” në vijim të hyrjes së Finest SpA, do të jetë prej Euro 4.400.000 (katërmilionekatërqindmijë) dhe kuotat e pjesëmarrjes së secilit partner – vazhdon gjithmonë Presidenti – do të jenë siç vijon:

FINEST SpA	11,36%
POLICLINICO TRIESTINO SpA	32,96%
OLTI PECINI	55,68%

Është parashikuar gjithashtu që të hartohet mes shoqërisë Policlinico Triestino SpA dhe Finest SpA një nënshkrim privat i cili të rregullojë marrëdhëniet reciproke të cilët lindin prej blerjes së sipërpërmendur të pjesëmarrjeve dhe të individëve dhe që të përcaktojë të drejtat e palëve, shërbimet e dhëna, detyrim-pagesat si dhe detyrimin për riblerjen e kuotave nga ana e Policlinico Triestino SpA Vazhdohet me diskutimin e gjerë dhe gjithëpërfshirës në përfundim të Këshillit të Administrimit unanimisht të atyre që kanë të drejtë vote

**vendos**



të aprovojë veprimin me Finest SpA sipas termave dhe kushteve të kësaj vendimmarrjeje dhe të njoftuara tek Politecnico Triestini SpA me letër Prot. 424/2009 të datës 18/11/2009;

të heqë dorë prej të drejtës së opsionit mbi rritjen e parashikuar të kapitalit të shoqërisë prej Euro 4.300.000 (katërmilontreqindmijë) në favor të Finest SpA;

- t'i delegojë Zv/Presidentit në fuqi, Z. Franco Stock, fuqitë më të gjera, të cilat nuk do të përmenden në detaje në mënyrë që të mos kufizohen, për të trajtuar, përmbyllur, nënshkruar, për të perfeksionuar dhe për të ekzekutuar marrëveshjet me Finest SpA, këtu përfshirë, pa qëllim kufizues, zotimin e Policlinico Triestino SpA që të riblejë pjesëmarrjen në shoqërinë Salus Tirana shpk në pronësi të Finest SpA në skadim dhe sipas modaliteteve dhe kushteve për të cilat është rënë dakord me këtë të fundit, edhe duke zgjeruar indikacionet dhe zotimet më sipër në mënyrë që prej asnjërit të mos perceptohet ndonjë defekt lidhur me fuqitë, duke konsideruar që prej tani di të mirëqenë dhe të vlefshëm çfarë do të kryhet prej Z. Franco Stock.

Duke qenë se nuk ka tjetër në rend të ditës për të cilën të merret vendim, mbledhja shpërndahet në orën 17.50, përmes hartimit, leximit, aprovimit dhe nënshkrimit të këtij verbali.

Presidenti

Sekretari

OMISSIS

**Numri i Repertorit 5755**

Kopje ekstrakti konform me origjinalin i cili përmbahet në faqet 2004/027 deri 2004/032, të Librit të verbalëve të Këshillit të Administrimit të "Policlinico Triestino S.p.A.", me seli në Trieste, Via Bonaparte n. 4, Kod Fiskal 00139620322, libër i mbajtur sipas ligjit përpara se të më tregohej mua, Noterit, mbajtur prej Shoqërisë së cilës i përket, i parë dhe menjëherë i kthyer, me shënimin se palët nuk duhet të ndryshojnë përmbajtjen e këtij ekstrakti.

**Trieste, në Via San Spiridone al civ.n.6, më 14 dhjetor 2009**